

L I G J

Nr.8304, DATE 12.3.1998

FZ. 7-1998

PER RATIFIKIMIN E "MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE
SE REPUBLIKES TE SHQIPERISE DHE QEVERISE MAQEDONASE PER
NDIHMEN JURIDIKE NE FUSHEN CIVILE DHE PENALE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ndihmën juridike në fushën civile dhe penale".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2021, datë 21.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SHQIPTARE DHE QEVERISE MAQEDONE

PER NDIHMEN JURIDIKE NE FUSHEN CIVILE DHE PENALE

Qeveria Shqiptare dhe Qeveria Maqedone per te intensifikuar mardheniet juridike midis dy vendeve, per te thelluar bashkepunimin ne sferen e Drejtesise dhe per te lehtesuar procedurat ligjore dypaleshe, rane dakort te perfundojne kete marreveshje.

KAPITULLI I

RREGULLA TE PERGJITHESHME

Neni 1

1. Shtetasit e njeres pale ne marreveshje gezojne te drejta te njejta gjate procedurave para gjykatave te pales tjeter ne marreveshje si dhe shtetasit e tij.
2. Shtetasit e njeres pale ne marreveshje paraqiten para gjykatave te pales tjeter nen te njejtat kushte si dhe shtetasit e tij.
3. Parashikimet e paragrafit te mesiperm u referohen edhe personave juridike.

Neni 2

Shtrirja e Ndhmes Juridike

1. Palet e vendeve ne marreveshje japin ndihme juridike te dyanshme ne fushen civile dhe penale dhe procedimet ne rastet e shkeljes se menyres dhe shtrirjes se kesaj Marreveshje.
2. Shprehja "fushe civile" per kete Marreveshje pefshin te drejtat civile, kontraktuale, si dhe te gjitha kerkesat e tjera pasurore dhe familjare.
3. Shprehja " fushe penale " per kete marreveshje pefshin veprat penale te denueshme nga legjislacioni i te dy vendeve.

4. Organet e Drejtesise te te dy paleve ne perputhje me parashikimet e kesaj Marreveshje, i japin ndihme juridike organeve qe sipas legjislacionit te pales perkatese, jane kompetent per ceshtje te paragrafit 1 dhe 2 te kesaj Marreveshje

Neni 3

Ndihme juridike sipas kesaj Marreveshje konsiderohet: dorezimi i nje thirrje per gjyq, dhenia e provave materiale ose shkresore, dhenia e informacionit nga evidencat penale (gjendja gjyqesore), degjimi i paleve, deshmitareve, eksperteve gjyqesore dhe personave te tjere, kontrolli i baneses, vendeve te tjera dhe kontrolli personal, ngritja e padise civile ose penale, ndalimi, legalizimi i dokumentave, njohja dhe permbushja e vendimeve te gjykatave ne ceshtje penale, shkembim i rregulloreve dhe materialeve, dokumenteve te paleve te shteteve kontraktuese dhe te tjera.

Neni 4

Menyra e Komunikimit

1. Organet kompetente te paleve komunikojne per efekt te kesaj marreveshje nepermjet Ministrive te Drejtesise te te dy vendeve.
2. Parashikimi I paragrafit 1 te ketij neni nuk perjashton te drejten per te komunikuar ne rruge diplomatike.
3. Ne raste urgjente ose te vecanta oganet kompetente te paleve dergojne kerkesat ose u pergjigjen organeve kompetente te pales tjeter nepermjet INTERPOL-it.

Neni 5

Gjuha

1. Kerkesa per ndihme juridike (tani e tutje e quajtur kerkesa) si dhe te gjitha dokumentat e tjera, te cilat sipas kesaj Marreveshje duhet te paraqiten nga pala e interesuar te perkthyer ne gjuhen e vendit te cilit i drejtohet kerkesa, (tani e tutje i quajtur vendi adresues), ne te kundertet vendi i adresuar i kthen pa veprim neqoftese nuk ka nje marreveshje te ndryshe.
2. Pergjigjet e kerkesave dergohen ne gjuhen e vendit te adresuar.
3. Dokumenti i dorezuar personit te vendit te adresuar dorezohet ne gjuhen e vendit adresues dhe duhet te perkthehen ne gjuhen e vendit te adresuar.

4. Neqoftese nje perkthim nuk eshte bashkengjitur, dorezimi mund te behet nese marresi i pranon dokumentet.

Neni 6

Kerkesa per Ndhme Juridike

(1) Kerkesa per ndihme juridike duhet te permbaje:

1. Titullin e organit qe kerkon ndihmen dhe organit te cilit i eshte kerkuar ndihme juridike.
2. Pershkrimi i procedurave per te cilat ndihma juridike kerkohet ne ceshtjet penale dhe civile dhe ndryshimet ligjore te vepres penale.
3. Informacionin e nevojshem per te permbushur procedimin e dhenies se ndihmes juridike.
4. Identiteti i personave ne procedure, data e lindjes, vendi i banimit ose vendi ku jeton, shtetesia, ndersa per personat juridike, emertimi, selia dhe te dhena te tjera identifikuese sipas ligjit te vendit perkates.
5. Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit ose mbrojtetit ne procedurat gjyqesore.

(2). Kerkesa dhe dokumentacioni tjetër duhet te nenshkruset dhe vulozet nga organi qe kerkon ndihme juridike.

Neni 7

1. Ndhma juridike jepet ne perputhje me legjislacionin e vendit te adresuar.
2. Organi kompetent qe jep ndihme juridike mund te veproje ne menyren dhe ne rrugen e kerkuar nga vendi adresues neqoftese nuk eshte ne kundertshtim me kerkesat ligjore te vendit te adresuar.

Neni 8

1. Ne qofte se organi i adresuar te cilit i drejtohet kerkesa nuk eshte kompetent per t'ju pergjigjur, kerkesa duhet t'i dorezohet organit kompetent te vendit te pales se te ardesuarit dhe te njoftoje per kete veprim vendin kerkues.
2. Neqoftese kerkesa nuk mundt te ndiqet, eshte e detyrueshme te njoftohet vendi kerkues menjehere duke dhene shkaqet perkatese. Ne qofte se bashkengjitur me kerkesen ka dhe dokumentacion shoqerues, ato duhet te kthehen me kete rast.

Neni 9

Vendi i adresuar mund te refuzoje dhenien e ndihmes juridike teresisht ose pjeserisht per aq sa eshte ne kundertshtim me rregullat ligjore te vendit te tij.

Neni 10

Dorezimi i Dokumenteve

Akti qe verteton dorezimin e dokumentit ne organin kopetent te vendit te adresuar, pervec te dhenave qe parashikohen ne Nenin 6 te kesaj Marreveshje, duhet te perfshijne identitetin dhe adresen e personit te cilit i eshte dorezuar dokumenti.

Neni 11

1. Dorezimi behet ne perputhje me rregullat dhe praktiken e vendit kerkues. Me kerkese te shprehur per shperndarjen e dokumentit mund te perdoret nje parashikim i vendit te marresit, per aq sa nuk eshte ne kundertshtim me rregullat e vendit kerkues.
2. Dorezimi i dokumentit provohet ne perputhje me rregullat qe jane te vlefshme ne vendin kerkues. Identiteti dhe data e dorezimit te dokumentit pasqyrohen nga organi kompetent ne certifikaten e marrjes.
3. Certifikata e marrjes dergohet menjehere ne vendin e marresit. Ne qofte se shperndarja nuk eshte e mundur, vendi i marresit duhet te lajmerohet per arsyet dhe kur eshte vendi zbatohet rregulli i parashikuar ne Nenin 8 pika 2 te kesaj Marreveshje.

Neni 12

Informimi Lidhur me Rregullat

Me kerkese te vendeve kontraktuese palet duhet te lajmerojne njera-tjetren per rregullat qe jane dhe kane qene te vlefshme ne territorin e tyre dhe ne rast nevojje ato duhet te shkembejne tekset e ketyre rregullave.

Neni 13.

Pagesa per Marrjen e Ndhimes Gjqesore

1. Vendet pale ne marreveshje nuk mund te kerkojne kompesim per tarifate dhe shpenzimet me karakter administrativ, pervec se per shpenzimet lidhur me veprime te caktuara procedurale, si ekspertizat, eksperimentet, pagesa per akte noteriale, per administrimin e provave, etj., pervecse kur eshte marre vesh ndryshe.
2. Organi te cilit i adresohet mund te kerkoje parapagese lidhur me detyrimet qe rrjedhin nga paragrafi 1 i ketij neni, te cilave kur cmon me vend u pergjigjet paraprakisht vendi i adresuar per llogari te vendit kerkues.

KAPITULLI II

NDIHMA JURIDIKE NE FUSHEN CIVILE

Neni 14

Parimi i Barazise

Shtetasit e nje vendi pale ne marreveshje jane te lire nga detyrimet ndaj gjykates ne procedimet gjyqsore sipas te njejtave kushte dhe tarife sikurse shtetasit e vendit ku kryen veprimet.

Neni 15

Perjashtimi i Pageses se Detyrimeve ne Procedimet Gjyqsore.

1. Per perjashtimin e detyrime nga neni 14 i kesaj marreveshjeje merr vendim gjykata e vendit ku procedohet sipas propozimit te paleve. Ne perputhje me dispozitat ligjore te vendit prites, per perjashtim nga tarifate ne procedimet gjyqsore, vendoset mbi bazen e vertetimit te leshuar nga organi kompetent i vendit ne territorin e te cilit personi ka vendin e perhershem te banimit ose te qendrimit.
2. Ne rastet e paragrafit te 1 te ketij neni, kur personi ka vendbanim ose qendrim te perhershem ne territorin e nje vendi te trete, nje certifikate mund t'i leshohet nga misioni diplomatik ose konsullor i vendit pale ne kete marreveshje, shtetas i te cilit eshte ky person.
3. Gjykata e vendit prites, e cila eshte kopetente per te vendosur per perjashtimin sipas pikes 1 te ketij neni, mund te kerkoje informacion shtese.

Garancite Gjyqesore

Neni 16

1. Per nje shtetas te nje pale te vendit ne marreveshje qe paraqitet para gjykates se pales tjeter si padites ose person i interesuar, nuk lejohet te kerkohet garanci pavaresisht nga lloji apo destinacioni vetem sepse ai/ajo eshte nje shtetas i huaj dhe nuk ka vend te qendrueshem rezidence ne ate vend.
2. Parashikimet nga paragrafi 1 i ketij neni u referohen edhe personave juridike.

Neni 17

Regjistrimi i Dokumenteve dhe Akteve

1. Dokumentat dhe aktet ne forme te rregullt, te nxjerra ose te noterizuara nga gjykata ose nga organ tjeter kompetent i pales se vendit ne marreveshje, firmosur dhe vulosur nga organi kompetent, e ben te panevojshme nenshkrimin dhe noterizimin e kerkeses ne territorin e vendit tjeter.
2. Paragrafi 1 i ketij neni i referohet edhe rishkrimit dhe kopjeve te dokumentave qe jane te vertetuara nga gjykata ose ndonje organ tjeter kompetent.

Neni 18

Dokumentet si pasaporta ose karta e identitetit te leshuara na territorin e nje nga paleve ne kete marreveshje, kane fuqine e evidences ne territorin e pales tjeter si dokumente shteterore te vendin tjeter.

Neni 19

1. Palet ne marreveshje reciprokisht pajisin me certifikata qe pasqyrojne te dhena te regjistrave dhe vendime te formes se prere te gjykatave lidhur me gjendjen personale te shtetasve te vendit tjeter.
2. Pajisja me dokumentat qeveritare dhe vendimet e gjykates te paragrafit te pare te ketij neni behet falas cdo 6 muaj me rruge diplomatike.

Neni 20

Njohja dhe Permbushja e Vendimeve te Gjykates

Palet kontraktuese, sipas kushteve te kesaj marreveshje, njohin dhe permbushin ne territorin e tyre vendimet e gjykatave respektive, ne procedimet civile dhe i konsiderojne ato si vendime te perfunduara perpara gjykates te pales tjeter.

Neni 21

(1) Vendimet e gjykates nga neni 20 i kesaj marreveshje njihen dhe permbushen:

1. Nese nje vendim eshte i formes se prere dhe i ekzekutueshem ne perputhje me ligjin e vendit ne territorin e te cilit eshte marre vendimi.

2. Nese per procedimet gjyqsore ne te cilat vendimi bazohet, gjykata e pales ne territorin e se ciles kerkohet njohja dhe permbushja e vendimit te gjykates nuk eshte kopetente.

3. Ne rastin e sjelljes se nje vendimi gjyqsor ne munges, personi, i cili nuk eshte paraqitur perpara gjykates dhe nuk ka marre pjese ne procedimet dhe vendimi i gjykates kunder tij/ saj ne baze te ligjit te pales ne territorin e te ciles eshte zhvilluar procedimi, lajmeruar rregullisht dhe ne kohe rreth procedimit ndersa ne rastin e paaftesise se tij/saj per t'u paraqitur edhe nese eshte ligjerisht i keshilluar.

4. Nese ne te njejtin procedim gjyqsor midis paleve nuk eshte marre vendim i zbatueshem nga gjykata e vendit ne territorin e se ciles kerkohet njohja ose permbushja e vendimit te gjykates.

5. Nese para gjykates se vendit te derguesit nuk ka paraprakisht procedime ligjore te per te njejten ceshtje dhe midis te njejtave pale.

(6). Nese njohja dhe permbushja e vendimit nuk eshte kundra sistemit gjyqsor te vendit te derguesit dhe sistemit te tij kushtetues.

(2). Nje vendim per njohje dhe permbushje te vendimit te vendit te kerkuesit ben kompetente gjykaten e vendit tjeter.

Neni 22

(1). Ai qe kerkon njohjen dhe permbushjen e nje vendimi gjyqsor, kerkesen i'a paraqet gjykates se vendit te pales se vendit kontraktues qe vendos mbi njohjen dhe ekzekutimin, ose gjykates se pales se vendit pale qe ka dhene vendimin. Dorezimi i nje kerkeses gjykates kompetente per vendimmarrjen, per njohjen dhe permbushjen do te kryhet ne perputhje nenin 4 te kesaj Marreveshje

(2). Kerkeses per njohjen dhe permbushjen e nje vendimi gjyqsor duhet t'i perfshihet :

1. vendim i gjykates i formes se prere ose nje kopje e vertetuar e tij.

2. nje certifikate qe pala nuk mori pjese ne procesin gjyqsor dhe kundra se ciles u soll nje vendim gjyqsor, eshte thirrur sipas ligjeve dhe ne kohe i thirrur ne gjyq dhe ne rast kur pala nuk mund te paraqitet para gjykates dhe nje certifikate se ai/ajo eshte keshilluar juridikisht.

Neni 23

1. Procedura per njohje dhe permbushje te vendimit gjyqsor kryhet sipas ligjeve te vendit qe merr vendimin per njohje.

2. Nje kerkese per njohje dhe permbushje mund te dorezohet nga gjithkush qe ka nje interes ligjor per kete njohje apo permbushje.

KAPITULLI III

NDIHMA JURIDIKE NE FUSHEN PENALE

Neni 24

Palet sipas parashikimeve te kesaj marreveshje i japin njera-tjetres ndihme juridike ne te gjitha procedimet per vepra penale per te cilat ne kohen qe i eshte kerkuar ndihme juridike organet e drejtesise te vendit adresues kane qene kompetente.

Neni 25

Refuzimi i Ndhimes Juridike

(1). Palet ne marreveshje do refuzojne ndihmen juridike:

1. Ne qofte se vepra e cila citohet ne kerkese sipas ligjit te vendit te adresuar nuk eshte nje akt i ndeshkueshem.

2. Ne qofte se pranimi i kerkeses eshte ne kundersiztim me sistemin juridik te vendit te adresuar ose zakoneve te mira te atij vendi dhe kur prek integritetin e tij, sigurine dhe interesa te tjera themelore te vendit.

3. Ne qofte se kerkesa eshte ne lidhje me nje veprim qe sipas vendit te adresuar eshte veper penale politike ose ushtarake.

4. Kur ka arsye te mendohet se jane ushtruar ose do te ushtrohen persekutime ose diskriminime per shkak te races, fese, seksit, shtetesise, gjuhes, bindjeve politike dhe gjendjes shoqerore ose do te jepen denime ose do te kete trajtime te egra, c'njerezore a veprimtari te tjera qe cenojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut

Neni 26

Thirrja per Gjyq

Per te lajmeruar te pandehurit, deshmitaret ose pjesemarres te tjere ne proces te cilet jane thirrur nga pala e vendit tjetër nuk duhet t'u neshtrohen masave parandaluese ne raste te mosparaqitjes para gjykates. Ne qofte se i thirruri nuk i pergjigjet njoftimit, kunder tij nuk mund te merret mase penale.

Neni 27

Deshmitari ose eksperti qe paraqitet para gjykates se vendit adresues ka te drejten e kompesimit te shpenzimeve te udhetimit dhe qendrimit, ne perputhje me ligjet e vendit adresues.

Neni 28

Dorezimi i perkohshem i Personave te Privuar nga Liria

(1). Neqoftese pala e vendit ne te cilin zhvillohet procesi penal therret si deshmitar ose per t'u ballafaquar, nje person qe vuan denim ne vendin tjetër, ai dorezohet perkohesisht pasi te jete marre pelqimi i tij.

(2). Vendi adresues eshte i detyruar te ktheje personin e dorezuar perkohesisht brenda nje periudhe te caktuar nga vendi i adresuar.

(3). Dorezimi i perkohshem mund te refuzohet:

1. Neqoftese personi nga paragrafi 1 i ketij neni nuk jep pelqimin.

2. Neqoftese per shkak te dorezimit tejkalohej periudha e burgimit.

3. Kur jane shkaqet e parashikuara ne Nenin 26 te kesaj marreveshje.

(4). Dorezimi do te shtyhet neqoftese personi duhet te jete prezent ne nje proces penal qe zhvillohet ne territorin e vendit te adresuar.

(5). Nje person i dorezuar perkohesisht nga paragrafi 1 i ketij neni duhet te mbahet ne burg ne territorin e vendit adresues.

(6). Shprehja “ person i privuar nga liria “ ne kete marreveshje perfshin personat e denuar, arrestuar ose mse tjeter siguri me privim lirie.

Neni 29

Per dorezimin e personit sipas paragrafi 1 te nenit 28 te kesaj marreveshje, duhet te bien dakort organet kopetente te te dy paleve duke fiksuar daten e dorezimit dhe te kthimit, vendin dhe menyren e transportimit.

Neni 30

Mbrojtja e Lirive Personale

(1). Deshmitari ose eksperti kur thirren para gjykates se vendit adresues, pavaresisht nga shtetesia e tij/saj, s'duhet te akuzohet ose arrestohet ose ne ndonje menyre tjeter t'u kufizohet liria si rezultat i nje vepre penale qe ai/ajo ka kryer para ardhjes ne territorin e vendit te adresuar.

(2). Ndjekja penale, privimi nga liria ose ndonje menyre tjeter e kufizimit te lirise personale te personave nga paragrafi 1 i ketij neni aprovohet:

1. Ne qofte se sipas vendimit te gjykates prezenca e personit te thirrur nuk eshte me e nevojshme e megjithate personi qendron ne territorin e vendit adresues per me shume se 15 dite, megjithese kishte mundesite te largohet.

2. Ne qofte se personi pasi ka lene territorin e vendit te adresuar kthehet vullnetarisht ne territorin e tij.

Neni 31

Prezenca e Veprimeve ne Dhenien e Ndhimes Juridike

1. Mbi kerkesen te vendit adresues, vendi i adresuar do informoje vendin tjeter per vendin dhe daten e sakte te procesit ne lidhje me kerkesen.

2. Pjesemarresit ne procesin penal, keshilltaret e tyre juridike dhe perfaqesuesit e organeve te drejtesise se vendit adresues mund te jene prezent gjate dhenies se ndihmes juridike ne vendin e adresuar. Parashikimet e nenit 31 te kesaj marreveshje aplikohen edhe ndaj tyre.

3. Per perzencen e perfaqesuesve nga organet e drejtesise te vendit adresues ne dhenien e ndihmes juridike nje miratim eshte i nevojshem nga vendi i adresuar. Ky aprovim jepet nga Ministria e Drejtesise e vendit perkates.

Neni 32

Shkembimi i Informacioneve per te Dhenat nga Evidencat Penale

1. Palet informojne ne menyre te dyanshme per te gjitha denimet e shtetasve te pales se vendit tjeter qe ekzistojne ne evidencen e tyre penale. Informacioni mbi evidencen penale shkembet cdo 6 muaj ndermjet Ministrive te Drejtesise se te dy vendeve.
2. Palet e te dy vendeve, kur e shohin me vend ose me kerkese, informojne njera-tjetren edhe per te dhena te tjera te evidences penale.

Neni 33

Besueshmeria e Procesit Penal

1. Neqoftese nje shtetas i njerës pale kryen nje veper penale ne territorin e pales tjeter, vendi ne territorin e te cilit u krye kjo veper ka te drejte te kerkoje qe te ndermarre ndjekje penale ne kushtet e kesaj Marreveshje.
2. Organet kompetente te vendit te adresuar do vazhdojne procedimin penale ne baze te rregullave te vendit vendit qe i adresohet
3. Neqoftese nje person, kunder te cilit ka nje proces penal, eshte i ndaluar ne vendin adresues, vendi, ne perputhje me parashikimet e nenit 30 te Marreveshjes do ta transferoje ate ne vendin e adresuar.

Neni 34

(1). Kerkeses per ndermarrje te procesit penal duhet t'i bashkangjiten:

1. Dokumentat ne origjinal ose kopje te vertetuara.
2. Certificate per identitetin, vendbanimin, venqendrimin ose te dhena te tjera per shtetesine e personit per te cilin eshte kerkuar ndjekje penale.
3. Ekstrate te ligjit penal te aplikuar ne ate proces penal.
4. Deklarimi i personit te demtuar i cili jep miratim per veprimet e mesiperme.

Neni 35

Vendi i adresuar do informoje vendin adresues nese procedimi penal ka filluar. Ne qofte se procedimi penal nuk fillohet, ose pushohet, i gjithë dokumentacioni ne lidhje me kete rast do t'i kthehet vendit adresuesit se bashku me vendimin perkates te organit kompetent. Ne se procedimi i kerkuar penal eshte ndermarre, pas perfundimit te tij, shteti i adresuar duhet t'i komunikojë shtetit kerkues vendimin e formes se prere te gjykates.

KAPITULLI IV

Neni 36

Dispozita te Fundit

Kjo Marreveshje nuk i prek detyrimet qe rrjedhin nga marreveshjet shumpaleshe.

Neni 37

Kjo Marreveshje eshte subjekt ratifikimi. Ratifikimi nga secila pale behet ne perputhje me legjislacinin e vet.


Kjo Marreveshje hyn ne fuqi ne ditën e 30-te te shkembimit te instrumentave ratifikuese.

Neni 38

Kjo Marreveshje perfundohet per nje periudhe te papercaktuar kohe. Cdo pale mund te terhiqet nga kjo Marreveshje me njoftim zyrtar ne rruge diplomatike pas 6 muajve nga komunikimi i njoftimit.

Kjo Marreveshje eshte perfunduar me dt. 15. 01 .1998 ne Shkup ne dy kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe maqedone te cilat jane te barasvlefshme.

PER QEVERINE SHQIPTARE



PER QEVERINE MAQEDONE

